

**V E N D I M**  
**Nr.227, datë 6.5. 1999**

**PËR FURNIZIMIN ME GRURË NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE  
SHTETËRORE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore të furnizojë falas me 500 (pesëqind) ton grurë, nga gjendja e grurit në depot e saj në Kukës, prefekturën e Kukësit, për përballimin e nevojave emergjente, ushqimore, të të ardhurve nga Kosova.

2. Vlera prej 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekësh e 500 tonëve grurë të përballohet nga fondet e vëna në dispozicion të Ministrisë së Pushtetit Lokal, për të ardhurit nga Kosova.

3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore dhe prefektura e Kukësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**